Vendim nr. 293, datë 18.09.2026

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Asim Vokshi, Marjana Semini anëtarë, në datën 18.09.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 7 (P) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **PARTIA "SHQIPËRIA BËHET",** përfaqësuar nga kryetari i saj Adriatik Lapaj.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i aktit normativ nr. 3, datë 06.07.2026 "Për financimin e pjesshëm të organizimit të një aktiviteti kulturor turistik me përmasa ndërkombëtare", si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Në rast se brenda 45 ditëve, sipas nenit 101 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, akti miratohet nga Kuvendi, shfuqizimin edhe të ligjit miratues.
Pezullimi i zbatimit të aktit normativ nr. 3, datë 06.07.2026 "Për financimin e pjesshëm të një aktiviteti kulturor turistik me përmasa ndërkombëtare", deri në dhënien e vendimit përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 7, 18, 101, 124, 131, 134, shkronja "gj", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27, 31, 45, 49, 50, pika 1, dhe 51 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(Ligji Organik i Gjykatës)*.**

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja është person juridik i krijuar në përputhje me ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", të ndryshuar *(ligji nr. 8580/2000)* dhe i regjistruar me vendimin nr. 5, datë 30.09.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

2. Në datën 06.07.2026 Këshilli i Ministrave ka miratuar aktin normativ me fuqinë e ligjit nr. 3, datë 06.07.2026 "Për financimin e pjesshëm të organizimit të një aktiviteti kulturor turistik me përmasa ndërkombëtare" (*akti normativ nr. 3/2026*), i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 146, datë 07.07.2026. Ky akt ka për qëllim financimin e pjesshëm në masën 400.000.000 (katërqind milionë) lekë të organizimit dhe të mbarëvajtjes së koncerti të artistit të njohur ndërkombëtar *Kanye West* (YE), të parashikuar për t'u zhvilluar në Tiranë, në datën 11 korrik 2026, si një aktivitet kulturor turistik me ndikim në promovimin e turizmit dhe të imazhit të Republikës së Shqipërisë.

3. Në datën 23.07.2026 Kuvendi i Shqipërisë, në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, ka miratuar ligjin nr. 75/2026, datë 23.07.2026 "Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 3, datë 06.07.2026 të Këshillit të Ministrave "Për financimin e pjesshëm të organizimit të një aktiviteti kulturor turistik me përmasa ndërkombëtare'", i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 176, datë 07.08.2026.

4. Në datën 10.07.2026 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me kërkesë për shfuqizimin e akti normativ nr. 3/2026, si të papajtueshëm me Kushtetutën, dhe pezullimin e zbatimit të tij, si dhe të çdo akti tjetër që do të miratohet, deri në dhënien e vendimit përfundimtar të Gjykatës. Kjo kërkesë, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 13.07.2026. Në datën 27.07.2026 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

II

Pretendimet e kërkueses

5. ***Kërkuesja,*** në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar si vijon:

5.1. *Për legjitimimin*

5.1.1. Kërkuesja legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, pasi veprimtaria e saj lidhet me forcimin e shtetit të së drejtës, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, garantimin e garës dhe të meritokracisë, si dhe funksionimin demokratik të Republikës së Shqipërisë. Për më tepër, si parti parlamentare, e përfaqësuar në Kuvend me një deputet, ajo mbart interes të ligjshëm për kundërshtimin e miratimit të një akti normativ që, në thelb, anashkalon filtrat parlamentarë të kontrollit të zakonshëm.

5.2. *Për pezullimin e zbatimit të aktit normativ nr. 3/2026, si dhe të akteve të tjera*

5.2.1. Në kushtet kur nuk është e qartë sesi do të procedohet nga Kuvendi, pezullimi i zbatimit të aktit normativ është i nevojshëm, pasi në rast të transferimit të shumës së miratuar te subjekti privat përfitues, mbrojtja e interesit publik dhe rikthimi i këtyre fondeve në buxhetin e shtetit do të vështirësoheshin ndjeshëm.

5.3. *Për themelin e çështjes,* kërkuesja ka parashtruar se akti normativ nr. 3/2026 cenon:

5.3.1. *Kërkesat kushtetuese të parashikuara në nenin 101 Kushtetutës,* pasi akti normativ nr. 3/2026 është miratuar në mungesë të kushteve të nevojës dhe të urgjencës. Relacioni shoqërues i aktit nuk evidenton se cila është situata faktike që justifikon ndërhyrjen urgjente të Këshillit të Ministrave. Aktiviteti për të cilin është miratuar financimi nuk ka qenë i papritur, pasi ka qenë i planifikuar dhe i publikuar që në datën 30.04.2026, ndërsa shitja e biletave ka filluar në datën 06.05.2026. Po kështu, në relacion nuk shpjegohet sesi dëmtohen interesat e shtetit nga moszhvillimi i koncertit, i cili përbënte një organizim tërësisht privat. Nëse financimi publik konsiderohej i nevojshëm, Këshilli i Ministrave kishte mundësinë t'i drejtohej Kuvendit përmes procedurave të zakonshme ligjvënëse ose buxhetore.

5.3.2. *Kërkesën për karakterin normativ të aktit*, pasi akti normativ nr. 3/2026 nuk vendos një regjim të përgjithshëm financimi për aktivitetet kulturore ose turistike, por rregullon një aktivitet konkret të lidhur me një artist të caktuar, favorizon vetëm një organizator privat dhe autorizon vetëm një pagesë konkrete. Për rrjedhojë, akti nuk ka karakter normativ, por individual.

5.3.3. *Parimin e barazisë përpara ligjit*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi financimi publik është parashikuar në favor të një operatori të vetëm privat, pa zhvillimin e një procedure konkurruese dhe pa përcaktimin e kritereve objektive që do t'u mundësonin edhe operatorëve të tjerë të konkurronin për përfitimin e tij.

5.3.4. *Parimin e shtetit të së drejtës dhe të sigurisë juridike*, të garantuar nga neni 4 i Kushtetutës, pasi financimi i drejtpërdrejtë me fonde publike i një operatori privat, që ka deklaruar se ndodhet në vështirësi financiare, përmes një akti normativ me karakter të individualizuar, krijon një precedent që cenon sigurinë juridike.

5.3.5. *Parimin e propocionalitetit*, pasi Këshilli i Ministrave nuk ka argumentuar domosdoshmërinë e financimit në masën 400. 000. 000 (katërqind milionë) lekë, mungesën e mjeteve të tjera më pak kufizuese për realizimin e qëllimit të synuar, si dhe raportin ndërmjet interesit publik të pretenduar dhe përfitimit privat.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

6. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe nga Ligji Organik i Gjykatës. Neni 134, pika 1, i Kushtetutës, përcakton në mënyrë shteruese subjektet që kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës.

7. Sipas nenit 134, pika 1, shkronja "gj", të Kushtetutës, partitë politike bëjnë pjesë në rrethin e subjekteve që mund të kërkojnë kontrollin e pajtueshmërisë së akteve normative me Kushtetutën. Megjithatë, si subjekte të kushtëzuara, në kuptim të pikës 2, të këtij neni, ato kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme ndërmjet interesave të tyre dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Po kështu, sipas nenit 49, pikat 3, shkronja "d", dhe 4, të Ligjit Organik të Gjykatës, partitë politike mund të paraqesin kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre, duke pasur detyrimin të provojnë në çdo rast se çështja lidhet drejtpërdrejt me të drejtat dhe me liritë e parashikuara nga Kushtetuta ose me qëllimin e veprimtarisë së tyre.

8. Në kuptimin kushtetues dhe ligjor, partitë politike paraqiten si bashkime vullnetare të shtetasve, të krijuara mbi bazën e ideve, të bindjeve e të pikëpamjeve politike të përbashkëta, që synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhje dhe përfaqësimit të

popullit në organet e zgjedhura të pushtetit. Bazuar në nenin 2 të ligjit nr. 8580/2000, ato marrin pjesë në formimin e vullnetit politik të popullit në të gjitha fushat e jetës publike, veçanërisht nëpërmjet ndikimit në krijimin e opinionit publik, nxitjes së pjesëmarrjes aktive të shtetasve në jetën politike dhe pjesëmarrjes në zgjedhjet e përgjithshme e vendore. Për shkak të rolit të tyre në funksionimin e demokracisë përfaqësuese dhe të sistemit zgjedhor, partitë politike kanë interes për ekzistencën e një kuadri ligjor të qartë dhe të drejtë që garanton pjesëmarrjen e tyre në proceset zgjedhore dhe ushtrimin e veprimtarisë politike *(shih vendimet nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 28, datë 09.05.2012; nr. 32, datë 21.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se statusi i një partie politike, si parti parlamentare, në kuptim të nenit 9 të Kushtetutës, ose roli i saj në formimin e vullnetit politik të zgjedhësve në të gjitha fushat e jetës publike, nuk nënkupton, në vetvete, ekzistencën e interesit për të kërkuar shfuqizimin e një ligji. Për justifikimin e këtij interesi, partia politike duhet të provojë se pasoja negative e aktit të kundërshtuar është e drejtpërdrejtë, reale dhe, sipas rastit, e lidhur ngushtë me funksionet e saj (*shih vendimet nr. 28, datë 30.06.2021; nr. 11, datë 13.03.2015; nr. 15, datë 15.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në këtë drejtim, Gjykata ka vlerësuar se mundësia e partive politike për të vënë në lëvizje kontrollin kushtetues ekziston kur ato kundërshtojnë dispozitat e akteve normative, të cilat cenojnë statusin e tyre kushtetues, bashkë me të edhe pjesëmarrjen e tyre në ushtrimin e vullnetit shtetëror. Të tilla mund të jenë aktet që përcaktojnë deklarimin e pasurive, financimin e tyre nga shteti ose subjekte të tjera, dhënia e shansit të barabartë të të gjitha partive për të marrë pushtetin, mënyra e organizimit dhe e ushtrimit të veprimtarisë së tyre politike jo vetëm gjatë zgjedhjeve, por edhe në periudhën midis tyre *(shih vendimet nr. 28, datë 09.05.2012 ; nr. 15, datë 15.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese).*

11. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se për të vlerësuar interesin e partive politike në çështjen në gjykim, nuk mbështetet vetëm në dokumentet e themelimit dhe statutin e tyre, por edhe në shtrirjen e anëtarësisë, veprimtarinë dhe shkallën e përfaqësimit politik të tyre në organet e zgjedhura (*shih vendimin nr. 15, datë 15.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Mbledhja e Gjyqtarëve ka mbajtur qëndrimin se interesat programore ose politike të një partie, interesat (e ligjshëm) të anëtarëve-individë të saj, madje edhe një interes i përgjithshëm i lidhur me sistemin demokratik, kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë, nuk i jep një partie politike të drejtën për të paraqitur kërkesë për shqyrtimin e kushtetutshmërisë ose të ligjshmërisë. Një

interes i ligjshëm, me karakter të përgjithshëm dhe abstrakt, që mund të demonstrojë dikush, nuk mjafton. Partia politike duhet të demonstrojë që rregullimi ligjor i kundërshtuar ndërhyn direkt në të drejtat, interesat e ligjshëm ose pozitën juridike (ligjore) të saj. Po në këtë këndvështrim, partitë politike nuk janë të legjitimuara për të paraqitur kërkesë përpara Gjykatës për çështje që lidhen me interesat e anëtarëve ose të simpatizantëve të tyre, por vetëm për çështjet që prekin rolin e tyre kushtetues si faktorë qendrorë të formimit të vullnetit politik të zgjedhësve *(shih vendimet nr. 32, datë 28.03.2022; nr. 151, datë 13.12.2021; nr. 113, datë 13.10.2011 të Mbledhjes së Gjyqtarëve).*

13. Nga standardet e mësipërme, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se legjitimimi i partive politike për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues nuk buron vetëm nga statusi i tyre juridik ose nga qëllimet e përgjithshme të veprimtarisë së tyre. Ai kërkon vlerësimin e lidhjes konkrete ndërmjet interesave që ato përfaqësojnë dhe përmbajtjes së aktit normativ të kundërshtuar. Në këtë vlerësim mund të mbahen parasysh edhe veprimtaria, edhe shkalla e përfaqësimit politik të partisë, por këto elemente duhet të shqyrtohen në raport me natyrën e çështjes kushtetuese të ngritur dhe ndikimin e aktit të kundërshtuar në të drejtat ose funksionet e saj.

14. Në rastin në shqyrtim, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkesa është paraqitur nga partia "Shqipëria bëhet", si person juridik i krijuar dhe i regjistruar në përputhje me ligjin. Sipas statutit të saj, kërkuesja është një bashkim vullnetar i shtetasve shqiptarë që, mbi bazën e ideve, bindjeve, pikëpamjeve dhe interesave të përbashkëta politike, synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhje dhe përfaqësimit të popullit/qytetarëve në organet e zgjedhura *(shih pikën 1.1. të statutit)*. Ndërsa sipas programit të saj politik, veprimtaria e kërkueses synon forcimin e shtetit të së drejtës, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, garantimin e garës dhe të meritokracisë, si dhe funksionimin demokratik të Republikës së Shqipërisë (*shih preambulën e programit politik të kërkueses).*

15. Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se pretendimet e kërkueses lidhen, në thelb, me mungesën e kushteve kushtetuese të nevojës dhe të urgjencës për miratimin e aktit normativ nr. 3/2026, karakterin e tij të individualizuar, si dhe cenimin e pretenduar të parimeve të barazisë përpara ligjit, shtetit të së drejtës, sigurisë juridike dhe të proporcionalitetit. Këto pretendime mbështeten kryesisht në faktin se akti normativ ka autorizuar financimin me fonde publike të një aktiviteti privat të përcaktuar, pa u argumentuar, sipas kërkueses, domosdoshmëria e kësaj ndërhyrjeje dhe pa u garantuar një procedurë konkurruese për operatorët e tjerë.

16. Për sa i përket interesit për vënien në lëvizje të Gjykatës, kërkuesja është mbështetur në qëllimet e veprimtarisë së saj politike, të përcaktuara në statut dhe në programin politik, si dhe në statusin e pretenduar si parti parlamentare, e përfaqësuar në Kuvend me një deputet. Në këtë kontekst, ajo ka argumentuar se miratimi i aktit normativ, sipas nenit 101 të Kushtetutës, ka shmangur mekanizmat e zakonshëm të kontrollit parlamentar, duke prekur interesin e saj për garantimin e funksionimit demokratik të institucioneve dhe për respektimin e parimeve kushtetuese.

17. Duke iu referuar standardeve të mësipërme, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkuesja nuk ka arritur të justifikojë interesin e saj për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Ndonëse pretendimet e ngritura lidhen me respektimin e kërkesave kushtetuese për miratimin e akteve normative me fuqinë e ligjit dhe me përdorimin e fondeve publike, kërkuesja nuk ka argumentuar se në çfarë mënyre akti normativ nr. 3/2026 prek drejtpërdrejt statusin, të drejtat ose funksionet e saj kushtetuese si parti politike. Dispozitat e këtij akti nuk rregullojnë organizimin, financimin ose ushtrimin e veprimtarisë së saj politike dhe as kushtet e pjesëmarrjes së saj në formimin e vullnetit politik të zgjedhësve. Po kështu, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se fakti që kërkuesja është parti parlamentare, e përfaqësuar në Kuvend me një deputet, nuk është *per se* i mjaftueshëm për të justifikuar interesin e saj për kundërshtimin e aktit normativ. Argumenti për shmangien e mekanizmave të zakonshëm të kontrollit parlamentar lidhet me respektimin e procedurës kushtetuese të miratimit të aktit, por kërkuesja nuk ka shpjeguar sesi kjo rrethanë ka cenuar drejtpërdrejt të drejtat ose funksionet që i përkasin asaj si parti politike. Vlerësimi nëse janë respektuar kushtet e nevojës dhe të urgjencës, të parashikuara nga neni 101 i Kushtetutës, i përket shqyrtimit në themel të çështjes dhe nuk mund të zëvendësojë detyrimin e kërkueses për të justifikuar paraprakisht interesin e saj kushtetues. Nga ana tjetër, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se qëllimet e përgjithshme të veprimtarisë së kërkueses, që lidhen me forcimin e shtetit të së drejtës dhe garantimin e funksionimit demokratik të institucioneve, nuk përbëjnë, pa një lidhje konkrete me aktin e kundërshtuar, interes të mjaftueshëm kushtetues për vënien në lëvizje të Gjykatës. Edhe duke mbajtur parasysh veprimtarinë dhe shkallën e përfaqësimit politik të saj, Mbledhja e Gjyqtarëve nuk konstaton rrethana që të justifikojnë një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet aktit normativ të kundërshtuar dhe interesave kushtetuese të kërkueses.

18. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkuesja nuk ka provuar interesin e saj të drejtpërdrejtë, të sigurt dhe vetjak për vënien në lëvizje të Gjykatës dhe, si e tillë, nuk legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 134, pika 2, të Kushtetutës.

19. Për sa kohë që kërkuesja nuk plotëson kushtin e legjitimimit për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se nuk ka vend të ndalet për shqyrtimin e kërkesës për pezullimin e zbatimit të aktit normativ nr. 3/2026.

20. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja "b", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin paraprak të kërkesës së paraqitur nga partia "Shqipëria bëhet", me të cilën është kërkuar shfuqizimi i aktit normativ nr. 3, datë 06.07.2026 "Për financimin e pjesshëm të organizimit të një aktiviteti kulturor-turistik me përmasa ndërkombëtare", si i papajtueshëm me Kushtetutën, si dhe pezullimi i zbatimit të tij, jemi kundër vlerësimit të shumicës se kërkuesja, në cilësinë e partisë politike, si subjekt i kushtëzuar, nuk justifikon interesin e saj për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih paragrafin 18 të vendimit*). Në vlerësimin tonë, çmojmë se në rastin konkret plotësoheshin të gjitha kriteret e pranueshmërisë, ndaj çështja duhej të kishte kaluar për shqyrtim në seancë plenare, për arsyet e mëposhtme.

2. *Së pari*, për sa i takon legjitimimit *ratione personae* të subjekteve të kushtëzuara, Gjykata ka pohuar se sipas nenit 134, pika 2, të Kushtetutës, ato duhet të justifikojnë interesin në çështjen konkrete, i cili duhet të jetë i drejtpërdrejtë, aktual dhe i lidhur ngushtë me detyrat dhe funksionet e tyre (*shih vendimin nr. 40, datë 16.11.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Në zbatim të këtij standardi, për organizatat, Gjykata ka kërkuar të justifikohet lidhja e drejtpërdrejtë dhe e individualizuar midis normës së kundërshtuar dhe qëllimit të veprimtarisë së tyre, sipas ligjit ose statutit (*shih vendimet nr. 30, datë 04.03.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 4, datë 15.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*), ndërsa për partitë politike jurisprudenca nuk ka qenë e njëtrajtshme. Në disa raste, legjitimimi është kushtëzuar me cenimin e statusit të tyre kushtetues dhe pjesëmarrjes në formimin e vullnetit shtetëror (*shih vendimet nr. 28, datë 30.06.2021; nr. 28, datë 09.05.2012 të Gjykatës Kushtetuese*), në raste të tjera është mbështetur në shkallën e përfaqësimit politik dhe rolin e partive në kontrollin e qeverisjes (*shih vendimin nr. 15, datë 15.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*), ose në lidhjen midis çështjes kushtetuese dhe qëllimeve të veprimtarisë së tyre programore (*shih vendimin nr. 1, datë 16.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

3. Në rastin konkret, shumica ka arsyetuar se partia politike legjitimohet kur arrin të provojë një lidhje konkrete mes interesave që ajo përfaqëson dhe përmbajtjes së aktit të kundërshtuar, duke mbajtur në konsideratë në këtë kuadër edhe veprimtarinë e shkallën e përfaqësimit politik të saj, të cilat shqyrtohen në raport me natyrën e çështjes kushtetuese të ngritur dhe ndikimin e aktit të kundërshtuar në të drejtat ose funksionet e saj (*shih paragrafin 13 të vendimit*). Sipas shumicës, në rastin konkret kërkuesja nuk ka arritur të justifikojë interesin e saj kushtetues, pasi nuk ka argumentuar se në çfarë mënyre akti normativ cenon drejtpërdrejt statusin, të drejtat ose funksionet

e saj si parti politike. As përfaqësimi i saj parlamentar dhe as qëllimet e përgjithshme të veprimtarisë, që lidhen me forcimin e shtetit të së drejtës dhe funksionimin demokratik të institucioneve, nuk përbëjnë interes të mjaftueshëm kushtetues, në mungesë të një lidhjeje të drejtpërdrejtë me aktin e kundërshtuar. Për rrjedhojë, sipas shumicës, kërkuesja nuk ka provuar një interes të drejtpërdrejtë, të sigurt dhe vetjak për vënien në lëvizje të Gjykatës, ndaj nuk legjitimohet *ratione personae*, sipas nenit 134, pika 2, të Kushtetutës (*shih paragrafët 17 dhe 18 të vendimit*).

4. Në ndryshim nga shumica, ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se çështja konkrete përbën një rast për zhvillimin e jurisprudencës kushtetuese në drejtim të saktësimit të kuptimit të konceptit "*çështje që lidhen me interesat e partive politike*", sipas nenit 134, pika 2, të Kushtetutës, për shkak të rëndësisë që ai paraqet për garantimin e aksesit të tyre në gjykimin kushtetues. Në këtë drejtim, është e nevojshme të qartësohet edhe raporti midis standardeve të legjitimimit të partive politike dhe atyre të organizatave, të cilat bëjnë pjesë në të njëjtën kategori kushtetuese të subjekteve të kushtëzuara. Kjo merr rëndësi veçanërisht në kushtet kur, për organizatat, Gjykata ka konsoliduar një jurisprudencë që e lidh legjitimimin e tyre me ekzistencën e një "*lidhjeje të drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis veprimtarisë së saj dhe normës që kundërshton*" (*shih sipër paragrafin 3*).

5. Në këtë kontekst, duhet mbajtur në konsideratë se partitë politike, ndonëse gëzojnë një status të veçantë kushtetues, në thelb përbëjnë organizime kolektive të individëve, nëpërmjet të cilave ushtrohet liria e organizimit për qëllime politike, e garantuar nga nenet 9 dhe 46 të Kushtetutës. Ato janë bashkime vullnetare të individëve mbi bazën e ideve, bindjeve dhe pikëpamjeve të përbashkëta politike, që synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhje dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit (*shih vendimet nr. 31, datë 04.10.2021; nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 11, datë 09.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, statusi i tyre i veçantë kushtetues nuk e përjashton natyrën e tyre si organizata, por pasqyron rolin specifik që ato përmbushin në sistemin e demokracisë përfaqësuese.

6. Po kështu, ndryshimet kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016, të cilat, ndër të tjera, zgjeruan rrethin e subjekteve që mund të vënë në lëvizje Gjykatën dhe rirenditën subjektet e kushtëzuara në nenin 134 të Kushtetutës, nuk japin arsye për një interpretim më kufizues të aksesit të partive politike në raport me organizatat. Fakti që partitë politike dhe organizatat janë parashikuar në shkronja të veçanta, përkatësisht në shkronjat "gj" dhe "h" të pikës 1 të këtij neni,

pasqyron dallimin në natyrën dhe rolin e tyre kushtetues, por nuk nënkupton se partitë politike nuk kanë natyrë organizative ose që legjitimimi i tyre duhet t'u nënshtrohet kritereve më kufizuese për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Ky interpretim mbështetet edhe nga neni 49, pika 3, shkronja "d", i Ligjit Organik të Gjykatës, i cili vijon t'i trajtojë partitë politike dhe organizatat së bashku, pa vendosur kritere të dallueshme legjitimimi për këto dy kategori subjektesh.

7. Nisur nga sa më sipër, ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se standardi i lidhjes së drejtpërdrejtë dhe të individualizuar midis veprimtarisë së subjektit kërkues dhe normës së kundërshtuar duhet të gjejë zbatim edhe në vlerësimin e legjitimimit *ratione personae* të partive politike, duke mbajtur në konsideratë natyrën dhe rolin e tyre të veçantë kushtetues. Një interpretim i kundërt, që do ta kushtëzonte legjitimimin e partive politike vetëm me cenimin e drejtpërdrejtë të statusit të tyre kushtetues, do të krijonte një dallim të pajustifikuar në raport me organizatat e tjera. Në këtë mënyrë, partitë politike, pavarësisht rolit të tyre të posaçëm në formimin e vullnetit politik dhe funksionimit të demokracisë përfaqësuese, do të kishin një akses më të kufizuar në gjykimin kushtetues sesa organizatat e shoqërisë civile, ose organizimet e tjera me karakter politik, të cilat mund të kundërshtojnë norma që rregullojnë marrëdhënie të përfshira në qëllimet e veprimtarisë së tyre statutore. Një dallim i tillë nuk gjen mbështetje të mjaftueshme as në formulimin e nenit 134 të Kushtetutës, as në natyrën e funksioneve kushtetuese që përmbushin partitë politike.

8. Për më tepër, një interpretim kufizues i aksesit të partive politike në gjykimin kushtetues nuk do të ishte në përputhje me rolin që ato kanë në sistemin e demokracisë përfaqësuese. Sikurse ka theksuar Gjykata, ky rol nuk kufizohet në mobilizimin e shtetasve gjatë zgjedhjeve, por përfshin angazhimin e vazhdueshëm të partive politike në formimin e vullnetit politik dhe në ruajtjen e dinamikës së demokracisë. Ai ushtrohet si nga partitë në pushtet, ashtu edhe nga ato në opozitë, të cilat kanë një funksion veçanërisht të rëndësishëm në kontrollin e qeverisjes. Në këtë kuptim, krahas instrumenteve të kontrollit parlamentar, si pyetjet, interpelancat, komisionet hetimore dhe mocionet e mosbesimit, mundësia për të vënë në lëvizje kontrollin kushtetues të akteve normative përbën një mjet të rëndësishëm për përmbushjen e rolit të tyre në një shtet demokratik (*shih vendimin nr. 15, datë 15.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Për këtë arsye, interpretimi i kriterit të interesit të partive politike duhet të mbajë në konsideratë jo vetëm cenimin e statusit të tyre juridik, por edhe lidhjen e drejtpërdrejtë të çështjes kushtetuese me veprimtarinë dhe funksionet që ato ushtrojnë në kuadër të rolit të tyre kushtetues, veçanërisht kur bëhet fjalë për një parti politike

parlamentare, siç është kërkuesja. Në këtë kuptim, ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se në rastin konkret kriteri i justifikimit të interesit për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues duhet të konsiderohet i përmbushur.

9. *Së dyti*, kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, sipas nenit 50, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës. Akti normativ nr. 3/2026 është miratuar në datën 06.07.2026 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 146, datë 07.07.2026, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë më 10.07.2026, pra brenda afatit ligjor.

10. *Së treti*, në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesja ka pretenduar se akti normativ nr. 3/2026 është nxjerrë në mungesë të kushteve të nevojës dhe të urgjencës; cenon parimin e barazisë përpara ligjit, për shkak të përzgjedhjes së një subjekti privat për përfitimin e financimit publik, pa kritere objektive dhe procedurë konkurruese; cenon parimin e shtetit të së drejtës dhe të sigurisë juridike, për shkak të financimit të drejtpërdrejtë nga buxheti i shtetit të një subjekti privat përmes një akti normativ të individualizuar; si dhe cenon parimin e proporcionalitetit, për shkak të mungesës së domosdoshmërisë së financimit dhe të një raporti të drejtë ndërmjet interesit publik të pretenduar dhe përfitimit privat. Këto pretendime janë mbështetur në nenet 101, 18, 4 dhe 17 të Kushtetutës.

11. Në vlerësimin tonë, pretendimet e kërkueses dhe argumentet e parashtruara në mbështetje të tyre kanë, *prima facie*, natyrë kushtetuese. Çështja thelbësore që shtrohej për vlerësim lidhej me respektimin e parimeve themelore kushtetuese të barazisë përpara ligjit, konkurrencës dhe mbrojtjes së financave publike, në kontekstin e financimit të drejtpërdrejtë të një subjekti privat përmes një akti normativ me fuqinë e ligjit. Shqyrtimi i këtyre pretendimeve kërkonte një analizë të raporteve kushtetuese ndërmjet Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave, si dhe të kufijve të kompetencës së këtij të fundit për nxjerrjen e akteve normative me fuqinë e ligjit, përfshirë përmbushjen e kritereve të nevojës dhe të urgjencës, të cilat duhet të ekzistojnë njëkohësisht dhe të jenë faktike, objektive, të përcaktueshme e të pavarura nga vullneti i qeverisë. Në këtë kuadër, duhej të vlerësohej edhe nëse përzgjedhja e një subjekti privat pa procedurë konkurruese, si dhe financimi i tij i drejtpërdrejtë nga fondet publike, respektonin parimet e barazisë përpara ligjit, të sigurisë juridike dhe të proporcionalitetit. Për rrjedhojë, duke qenë se pretendimet e ngritura kishin natyrë kushtetuese dhe kërkonin një shqyrtim në themel, vlerësojmë se kërkuesja legjitimohej edhe *ratione materiae*.

12. Për të gjitha arsyet e mësipërme vlerësojmë se, në rastin konkret, ishte e nevojshme që çështja të kalonte për shqyrtim në seancë plenare.

Asim Vokshi, Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, anëtarë